Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0736

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), si dhe nenit 29 dhe 31 te Rregullores se Punës se OSHP-se në përbërje nga; Vjosa Gradinaj-Mexhuani Isa Hasani-Kryetar, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) BIG Partners Ltd, kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Ministria e Kulturës Rs Dhe Çjk në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zhvillimi i dokumentacionit teknik- projektit ideor dhe të hollësishëm të arkitekturës dhe të inxhinierisë për ndërtimin e "Teatrit të Operës dhe Baletit të Kosovës" në Prishtinë, në Republikën e Kosovës" me numër të prokurimit 207-22-11955-4-1-2, me 24/01/2024,mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "BIG Partners Ltd", me nr. 2023/0736, e datës 28/09/2023, e paraqitur kundër "Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues " të datës 11.08.2023, AK Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zhvillimi i dokumentacionit teknik- projektit ideor dhe të hollësishëm të arkitekturës dhe të inxhinierisë për ndërtimin e 'Teatrit të Operës dhe Baletit të Kosovës' në Prishtinë, më numër të prokurimit 207-22-11955-4-1-2.

2.Anulohet, "Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues " i datës 11.08.2023, i AK ,Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për aktivitetin e prokurimit me numër; 207-22-11955-4-1-2., dhe anulohet aktiviteti i prokurimit.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore OE "BIG Partners Ltd",sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Me 27/10/2023, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: Zhvillimi i dokumentacionit teknik-projektit ideor dhe të hollësishëm të arkitekturës dhe të inxhinierisë për ndërtimin e 'Teatrit të Operës dhe Baletit të Kosovës' në Prishtinë, në Republikën e Kosovës me nr. të prokurimit: 207-22-11955-4-1-2.

Me 11/08/2023, AK ka publikuar njoftimin ku ka rekomanduar për çmimin e parë OE me kodin 6842.

OE "BIG Partners Ltd", me datën 11/09/2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Më datë 18/09/2023, AK - Ministria e Kulturës RS Dhe ÇJK me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues. Të pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "BIG Partners Ltd", me datën 28/09/2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0736, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 2, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 1, të nenit 116 të LPP.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "BIG Partners Ltd" të dy ekspertët, eksperti shqyrtues dhe ai teknik përmes raportit nr. 2023/0736 kanë vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi 1: AK gjatë rivlerësimit ka emëruar komisionin e ri të vlerësimit nga juria profesionale për rivlerësim të ofertave të cilët në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë kanë bërë vlerësimin e projekt propozimeve për natyrën e prokurimit. Sa i përket çështjes së vlerësimit dhe poentimit me pikë të ofertave për projekt propozimet, mbetet në kompetencë të anëtarëve të jurisë profesionale të cilët e kanë bërë rivlerësimin e projekteve dhe në këtë çështje secili profesionist ka të drejtë të jap vlerësimet profesionale të cilat duhet respektuar pavarësisht rezultatit të poentimit. Eksperti teknik konsideron se pretendimi ankimor 1 është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi 2: Pas vlerësimit të pretendimit dhe analizës së projekteve si dhe raportit të komisionit të vlerësimit, eksperti konsideron ofertuesi me kodin 6842 në projekt propozimin ka marrë parasysh dhe i ka përfshirë në projekt edhe hapësirat e trajtuara jashtë detyrës projektuese duke i

inkorporuar në projekt propozim dhe parcelat nr. 06191-7 dhe 06191-8, asnjëra nga këto parcela të cilat janë paraqitur si parcela private nuk janë pjesë e dosjes së tenderit. Juria në këtë rast ka vlerësuar në kundërshtim me kërkesat e dhëna nga AK në dosjen e tenderit FDP "vendi ku do të realizohet projekti" dhe në kundërshtim me detyrën projektuese pasi që nuk i ka marrë parasysh tejkalimet / shkeljet e kërkesave të DT, duke shkelur nenin 55.26 të RrPP-së. Sa i përket zbulimit të identitetit të pjesëmarrësve në fazën e vlerësimit të projekt propozimeve eksperti teknik konstaton se është shkelur neni 80 paragrafi 2 i LPP, si dhe neni 55.24, 55.25 të RrPP-së. AK në këtë rast nuk ka vepruar në pajtim me LPP, pasi që është zbuluar identiteti i pjesëmarrësit gjatë fazës së vlerësimit në konkursin projektimit. Eksperti teknik konstaton se pretendimi 2 është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi 3: Eksperti teknik sa i përket përfshirjes së inovacionit të projekt propozimet e cekura konstaton se: Për projektin me kodin 6842 përfshirja e gjelbërimit të ulët në mbulesën e ndërtesës dhe formës së paraqitjes së objektit nuk janë praktika inventive sa i përket zhvillimit dhe përfshirjes së aspekteve inventive në projektimin e ndërtesave, përkundrazi gjelbërimi i paraqitur në jetëgjatësinë e shfrytëzimit të ndërtesës paraqet kosto shtesë duke minimizuar përfitimet në jetëgjatësinë e projektit. Aspekti inventiv i paraqitur ne projektin 0703 përmes teknologjive të avancuara në sistemin e paneleve mund të merret aspekti inventiv duke kursyer energjinë , njëkohësisht shfrytëzimin e resurseve natyrore për prodhimin e energjisë së gjelbër. Eksperti teknik konsideron te bazuar piken e pretendimit tek inovacioni. Pikat tjera të elaboruara në pretendimin 3 mund të konsiderohen se janë trajtuar nga juria profesionale dhe në bazë të kritereve edhe kanë vendosur poentimin, pavarësisht mospajtimit me jurinë profesionale këtu kjo çështje nuk mund të konsiderohet nga eksperti teknik meqenëse vlerësimi estetik dhe funksional janë çështje subjektive dhe secili profesionist mund të vlerësoj ndryshe nga të tjerët, pothuajse janë kritere të pamatshme. Eksperti teknik konsideron si të pabazuar pikën tek vlerat estetike dhe funksionale. Andaj siç u cekë më sipër Eksperti teknik konsideron se pretendimi 3 është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi 4: Eksperti konsideron se gjatë vlerësimit të fakteve të paraqitura në AK për projekt propozimin në kopje elektronike vërehet se kodi me nr. 6842 tek fajlli me nr.1.5 Exhibition materials ka paraqitur formatin PDF të fajllit me emër të ofertuesit me titull "230512_Gerber_Opera-ËB_Boards" që do të thotë se e ka shfaqur identitetin e vet, po ashtu edhe në vizatimet e paraqitura në këtë dokument janë të përshkruara emri i operatorit ofertues "Gerber Architekten" në secilën fletë të prezantimit. Në funksion të zbatimit të dispozitave të LPP, AK, duhet të marrë veprime të menjëhershme për çdo shkelje të dispozitave ligjore. Në këtë rast është shkelur dispozita neni 80 paragrafi 2 i LPP -së, si dhe neni 55.24, 55.25 të RrPP-së. Eksperti konsideron se pretendimi ankimor 4 është i bazuar. Sqarime shtesë: Gjatë vlerësimit të provave dhe shkresave të lëndës eksperti teknik ka vërejtur që në procesin e konkurrimit në fazën e dytë të procedurës, të gjitha projekt propozimet - palët ofertuese kanë zbuluar identitetin e kodit të tyre, në vazhdim po japim sqarimet në lidhje me zbulimin e identitetit për ofertuesit: Projekt propozimi me kodin 0703 ka zbuluar identitetin e konsulentit lokal duke e shfaqur me emër tek dokumenti "0703_1.4_Design Approach & Methodology Report". Eksperti teknik konsideron se edhe projekt propozimi me kodin 0703 ka zbuluar identitetin e tij në procesin e vlerësimit të projekt propozimeve. Projekt propozimi me kodin 2008 edhe pse nuk është pikë pretendimi dhe palë e interesit në procedurën në fjalë eksperti ka shqyrtuar provat dhe konsideron se i njëjti ka zbuluar identitetin e tij duke përshkruar me titull projektet e punuara dhe duke i zbuluar bashkëpunëtoret e tij. Dokumenti "2008 - 1.4 Design Approach and Methodology Report - The Podium". Eksperti konsideron se edhe projekt propozimi me kodin 2008 ka zbuluar identitetin e tij në procesin e vlerësimit të projekt propozimeve. Duke pasur parasysh faktet e gjetura eksperti teknik konsideron se secili nga OE ofertues ka bërë shkelje të dispozitave ligjore duke zbuluar identitetin qoftë për veten apo për bashkëpunëtoret/partnerët. Meqenëse të gjitha identitetet kanë qenë të zbuluara në fazën fillestare të vlerësimit të projekt propozimeve konsideroj që AK duhet të merr veprimet e duhura pasi që nuk mund të organizohet procesi i vlerësimit duke siguruar integritet dhe paanësi të procesit.

Përgjigje në Pretendimi 5: Eksperti teknik gjatë vizitës së organizuar në AK për verifikimin e fakteve të shtjelluara në ankesë ka konstatuar që të gjitha kopjet e projekt propozimit me kodin 6842 kanë qenë të

hapura. AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore neni 55.15 dhe 55.16 i RrPP-së. Eksperti konsideron se pretendimi ankimor 5 është i bazuar. Përfundim: Ekspertët sqarojnë se gjatë shqyrtimit të kësaj lënde kanë vërejtur disa shkelje në lidhje me këtë Konkurs Projektimi. Përveç Operatorit Ekonomik të shpërblyer me çmimin e parë, me kodin 6842 i cili ka shkelur nenin 80 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke e zbuluar identitetin e tij në secilën faqe të pikës 1.5 Exhibition materials të ofertës, të njëjtën shkelje kanë bërë edhe dy operatorët tjerë të përfshirë në listën finale të rezultateve, përkatësisht Operatori Ekonomik me shifrën 0703 dhe ai me shifrën 2008. Që të dy Operatorët Ekonomik, në ofertat e dorëzuara kanë dhënë informata të zbulimit të identitetit, përmes të cilave komisioni ka mundur të kuptoj qartë se kujt i përket Projekti Ideor. Operatori Ekonomik me shifrën 0703 në pikën 1.4_Design Approach & Methodology Report të ofertës së dorëzuar, në tre faqet e këtij dokumenti ka paraqitur emrin e anëtarit të konzorciumit me të cilin OE ka lidhur marrëveshje për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit. Emri i anëtarit të konzorciumit mund të gjendet në faqe 39, 45 dhe 46 të këtij dokumenti. Në këtë rast edhe Operatori Ekonomik me shifrën 0703 ka bërë shkelje të nenit 80, pika 2 e LPP-së. Gjithashtu ekspertët sqarojnë se edhe Operatori i fundit në listë me shifrën 2008 ka bërë shkelje të nenit 80, pika 2 e LPP-së duke dhënë indikacione për identitetin e tij dhe duke mos qëndruar anonim për komisionin vlerësues. OE me shifrën 2008, në pikën 1.4 Design Approach & Methodology Report- The Podium, në faqe 43 të këtij dokumentit, ka folur rreth një Projekti Ideor të realizuar para disa vitesh, ku përveç emrit të projektit, vitit pjesëmarrës, OE po ashtu jep informata edhe për vendin se ku ka marr pjesë, emrin e partnerit pjesëmarrës në atë garë si dhe çmimin e fituar. Të gjitha këto indikacione mundësojnë që juria të ketë lehtë të disponueshme të kuptoj se cili është identiteti i këtij operatori. Duke i marr parasysh të gjitha këto shkelje të cilat u evidentuan më lartë, të dy ekspertët, sqarojnë se që të tre Operatorët Ekonomik të mbetur në garë, nuk kanë qëndruar anonim pas kodit të zgjedhur, por që të tre kanë zbuluar identitetin e tyre para jurisë në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë, qoftë në pjesën grafike apo tekstuale të projekt propozimeve, si pasojë e kësaj, kredibiliteti i procesit është zbehur dhe se në këtë pikë, nuk mund të ketë vlerësim të paanshëm dhe konfidencial. Duke u bazuar në gjendjen reale të krijuar, të dy ekspertët vlerësojnë se tashmë rrethanat të cilat janë krijuar e bëjnë të pamundur që juria profesionale të bëjë vlerësim objektiv dhe të barabartë mes Operatorëve Ekonomik, pasi që është shkelur rregulli bazik, parimi kryesor që vlerësimi i drejtë të bëhet përderisa identiteti i asnjërit pjesëmarrësit nuk dihet, por qëndrojnë anonim. Marr parasysh këto fakte dhe shkeljet ligjore të cilat u evidentuan gjatë procesit të vlerësimit, dhe në bazë të nenit 43.5 pika g. të Rregullores së Prokurimit Publik, ekspertët vlerësojnë që ky proces i prokurimit duhet të anulohet.

Rekomandimi i ekspertit shqyrtues;

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për vendimin e AK-së dhe ekspertët rekomandojnë që të anulohet aktiviteti i prokurimit. OE ankues ka deklarua se nuk pajtohet me raportin e eksperteve shqyrtues duke qëndruar pranë parashtresës se tij me ane te se cilës ka kërkuar qe ky aktivitet duhet te kthehet ne Rivlerësim, nga ana tjetër Autoritet Kontraktues fare nuk është deklaruar lidhur me raportin brenda afatit ligjor siç përcaktohet me LPP.

-Konstatimet e panelit shqyrtues-

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik nr.83/20, e datës, 03.03.2020, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues me qellim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesa e Operatorit Ekonomik, Njoftimin për Kontratë, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për të shpërblyer me kontrate OE për aktivitetin e prokurimit, Raportin e Vlerësimit të Komisionit Vlerësuese të AK, Vendimin e Autoritet Kontraktues lidhur me Kërkesën për rishqyrtim.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik, neni 107 pika ;(iv) që përcakton" *të drejtën e palëve për të dorëzuar dëshmitë dhe argumentet në dëgjimin para OSHP-së, përfshirë provat dhe marrjen e dëshmitarëve në pyetje*", si dhe nenin 116 Procedurat e vendim-marrjes, paragrafi 1., të po ketij ligji që përcakton, "*Para marrjes së një vendimi përfundimtar mbi një çështje, OSHP mund të kërkojë nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë"* dhe të nenit 24 të Rregullores se Punës se OSHP-se n;83/20, Paneli më datën 10.01.2024, ka mbajt seance dëgjimore me qellim të sqarimit të pretendimeve ankimore, lidhur me objektin e ankesës, me pjesëmarrje të përfaqësuesve nga; Autoritetit kontraktues/Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Palës ankuese"Big Partners LTD ", Ambasada Gjermane, Eksperti shqyrtues dhe monitorues të shoqërisë civile, Demokraci Plus dhe GLPS. Paneli shqyrtues pas diskutimeve të palëve në këtë seance dëgjimore, dhe pas shtjellimit te provave dhe argumenteve të paraqitura ka ardhur te konstatimi, se në këtë aktivitet te prokurimit, me rastin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave tenderuese të Operatorëve ekonomike, ka pasur elemente identifikuese që kane zbuluar identitetin e ofertuesve dhe ky fakt është në kundërshtim me kërkesat e Dosjes se tenderit dhe ligjit LPP.

Paneli shqyrtues vlerëson se ekspertet në raportin e tyre kanë trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e OE ankues "BIG Partners Ltd" dhe të procesit në tersi të këtij aktiviteti të prokurimit. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankues dhe procesit të prokurimit si tersi, i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara dhe aktiviteti i tërësishëm i aktivitetit të prokurimit u përcjell me shkelje ligjore.

Paneli shqyrtues konstaton se në ketë aktivitet prokurimi/konkurs projektimi, ka pasur disa shkelje ligjore. Operatori Ekonomik i shpërblyer me çmimin e parë, me kodin 6842 ka shkelur nenin 80 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke e zbuluar identitetin e tij në secilën faqe të pikës 1.5 Exhibition materials të ofertës. Po ashtu të njëjtën shkelje kanë bërë edhe dy operatorët tjerë të përfshirë në listën finale të rezultateve, përkatësisht Operatori Ekonomik me shifrën 0703 dhe ai me shifrën 2008, duke dhënë informata të zbulimit të identitetit, përmes të cilave komisioni ka mundur të kuptoj qartë se kujt i përket Projekti Ideor.

Paneli shqyrtues konstaton se zbulimi i identitetit të OE pjesëmarrës në fazën e vlerësimit të projekt propozimeve, ka shkelur nenin 80 paragrafi 2 të Ligjit Prokurimit Publik, si dhe nenet; 55.24, 55.25 të Rregullores për Prokurim Publik nr.01/2022 dhe AK Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në këtë rast nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore te larte cituara të LPP, pasi ka pasur zbulim të identitetit të operatorëve ekonomik pjesëmarrës, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave tenderuese në konkursin projektimit.

Paneli shqyrtues bazuar ne argumentet e lartcekura dhe konstatimit të ekspertëve vlerëson se ankesa është si pjesërisht e bazuar e OE "BIG Partners Ltd", kundër "Njoftimin mbi Vendimin Autoritetit Kontraktues", lidhur me aktivitetin e prokurimit 207-22-11955-4-1-2. Ky aktivitet i prokurimit ka pasur shkelje të ligjit të cilat janë të konstatuara edhe në raportin e ekspertëve shqyrtues dhe teknik, andaj dhe përfundimisht anulohet vendimi për "Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues " i datës 11.08.2023 dhe anulohet në tërësi aktiviteti i tenderimit.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret me rastin e vendosjes ka përgjegjësi për ligjshmërinë e procesit të prokurimit sipas nenit 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimet të përsëritshëm të ankese të OE, vendosi ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- OE - **BIG Partners Ltd**
- Arkivës së OSHP-së: